REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 76/12 Data: 06.09.2012
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 76/12
Datë 06.09.2012

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 04.09.2012 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për akreditimin e Qendrës Edukative Sociale "Don Bosko", Prishtinë, për periudhën 3 vjeçare: 01/09/2012 - 01/09/2015 për këtë/o kualifikime të aprovuara:

1.1. Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit; niveli i KKK-së: (III)

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të krijohet një formë - test mbi vlerësimin e njohurive paraprake, Paraqitja e qartë e kritereve për pranim të kandidatëve. (Afati i fundit: 01.06.2013)
- Të vendoset e një kuti për dhënien e ndihmës se parë pasi që kabineti i Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit është i ndare nga kabineti i Saldimit. (Afati i fundit: 01.06.2013)
- Të vazhdohet në përfundimin e procedurave te sistemit për sigurimin e cilësisë, përfshirë edhe dokumentacionin dhe mekanizmat përkatës, vetëm për pjesën e aftësimeve profesionale (në mënyre identike me liceun, por me të dhëna te ndara), (Afati i fundit: 01.06.2013)

1.2 Instalues Elektrik; niveli i KKK-së: (III)

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të vendosen udhëzimet me masat mbrojtëse në secilin panel të ushtrimeve. (Afati i fundit: 01.11.2012)
- Lista e pajisjeve totale në kabinetin për elektroinstalues është e disponueshme vetëm nga ana e trajnerit (e vendosur brenda dollapëve te mbyllura me çelës). Lista duhet ë jetë e dukshme gjatë gjithë kohës. (Afati i fundit: 01.11.2012)
- Bazuar në standardet për sigurinë e kandidatëve të cilët punojnë me panele del se një panel nuk është i sigurt sepse çelësi diferencial është 0.5A. Rekomandohet që ky çelës të ndërrohet dhe të jetë 0.03A. (Afati i fundit: 01.11.2012)
- Kandidatët të nënshkruhen personalisht në listat e vijueshmërisë. (Afati i fundit: 01.11.2012)
- Rekomandohen veshmbathjet të cilat kontribuojnë në sigurinë e kandidatëve siç janë syzat mbrojtëse, dorezat. (Afati i fundit: 01.11.2012)
- Kutia e ndihmës së parë ishte e mbyllur me çelës dhe nuk kishte udhëzime për përdorim. Rekomandohet që ndihma e parë të jetë e hapur në çdo kohë. (Afati i fundit: 01.11.2012)

1.3. Instalues i Ngrohjes qendrore; niveli i KKK-së (III)

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të vazhdohet në përfundimin e procedurave të sistemit për sigurimin e cilësisë, përfshire edhe dokumentacionin dhe mekanizmat përkatës, vetëm për pjesën e aftësimeve profesionale (në mënyrë identike me liceun, por me të dhëna të ndara),(Afati i fundit: 01.06.2013)
- Dëshmitë mbi analizën e tregut për profilin e ngrohjes qendrore për të përcjellur risitë në fushën dhe kërkesat e tregut. (Në vazhdimësi)

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë:04.09.2012, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

-Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe

-Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet:

- "QSE" "Don Bosko" Prishtinë;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi

REPUBLIKA E KOSOVËS * AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE * NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY * NACIONALNI AUTRORITET ZA KVALIFIKACIJE * REPUBLIKA KOSOVA * REPUBLIC OF KOSOVA